

VENDIM
Nr.339, datë 3.9.1997

PËR CAKTIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKTKUSHTETUTËS

Në mbështetje të nenit 44 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të disa grupeve parlamentare.

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1) Krijimin e komisionit parlamentar prej 21 anëtarësh si përfaqësues të partive parlamentare me këtë përbërje:

PS	- 6 anëtarë
PSD	- 2 anëtarë
PAD	-1 anëtarë
PBDNJ	-1 anëtarë
PA	-1 anëtarë
PUK	-1 anëtarë
PD	-3 anëtarë
PR	-1 anëtarë
PB	-1 anëtarë
PLL	-1 anëtarë
PDK	-1 anëtarë
PBD	-1 anëtarë
PBSD	-1 anëtarë
PLD	-1 anëtarë (me status special)
PDD	-1 anëtarë (me status special)
PK	-1 anëtarë (e ftuar)
PBDK	-1 anëtarë (e ftuar)
PRD	-1 anëtarë (e ftuar)
PB	-1 anëtarë (e ftuar)

Dhe me bashkëkryetarë

Sabri Godo

Arben Imami

Komisioni zgjedh nga gjiri i tij dy nënkryetarë.

2. Për procedurat praktike të punës, krijimin e infrastrukturës së procesit kushtetues, krijimin e stafit teknik, të grupeve të konsulencës, koordinimin e konsulencës dhe oponencës së huaj, lidhjet me inatitucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare si dhe organizimin e debatit publik, ngarkohet komisioni parlamentar i ngritur për hartimin e Projektkushtetutës në bashkëpunim me Ministrinë e Reformës Legjislativë dhe Marrëdhënieve me Parlamentin.

3. Afatet do të jenë si vijon:

1-5 shtator	-Krijimi i komisionit Parlamentar
5-10 shtator	- Mbledhja e parë e komisionit:Prezantimi i qendrimeve të partive (i pranishëm TV)
10 shtator- 10 tetor	- Debat televiziv etj. për temat e kushtetutës. - Fushata e deputeteve me pyetsorin. - Sondazhet në opinionet publike
10 tetor- 30 nëntor	- Diskutime në Komision + Diskutimet në grupet konsultative + përgatitja e projektit nga stafi teknik. Bërja publike e këtij procesi.
1-25 dhjetor	- Oponenca e huaj për projektin.

3-10 janar Reflektimi mbi vërejtjet e oponencës së huaj.
10-31 janar Depozitimi i projektit në Kuvend dhe shqyrtimi i tij në grupet e komisionet parlamentare

4. Të mbështete në parim programin "Për procedurat praktike të punës dhe krijimin e infrastrukturës për hartimin e projektkushtetutës" që i bashkëngjitet këtij vendimi

5. Për shpenzimet e nevojshme që lidhen me angazhimin e monitorizuesve dhe zhvillimin e procesit kushtetues ngarkohet Këshilli i Ministrave të Sigurojë fondin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

PROGRAM PËR PROCEDURAT PRAKTIKË TË PUNËS DHE KRIJIMIN E INFRASTRUKTURËS PËR HARTIMIN E PROJEKTKUSHTETUTËS

Për të organizuar procedurat e nevojshme për hartimin e Projektkushtetutës, me qëllim që procesi të jetë efikas, i manovrueshëm dhe gjithëpërfshirës të vepohet me modulën e mëposhtëm:

I. INFRASTRUKTURA

Krijimi i një komisioni parlamentar prej 21 anëtarësh nga të cilët 12 i përkasin shumicës dhe 9 opozitës, që përfaqësojnë partitë politike parlamentare. Në komision marrin pjesë me status special 2 parti, ndërsa si të ftuara në mbledhjet e komisionit do të jenë edhe 4 parti të tjera dhe konkretisht:

PS	- 6 anëtarë
PSD	- 2 anëtarë
PAD	- 1 anëtar
PBDNJ	- 1 anëtar
PA.	- 1 anëtar
PUK	- 1 anëtar
PD	- 3 anëtar
PR	- 1 anëtar
PB	- 1 anëtar
PLL	- 1 anëtar
PDK	- 1 anëtar
PBD	- 1 anëtar
PBSD	- 1 anëtar
PLD	- 1 anëtar (me status special)
PDD	- 1 anëtar (me status special)
PK	- 1 anëtar (e ftuar)
PBDK	- 1 anëtar (e ftuar)
PRD	- 1 anëtar (e ftuar)
PB	- 1 anëtar (e ftuar)

Bashkëkryetarë të komisionit do të jenë zoti Sabri Godo dhe zoti Arben Imami, kurse dy nënkryetarë do të zgjidhen nga gjiri i komisionit.

Ky komision do të punojë në mënyrë të vazhdueshme dhe do të marrë vendimet politike për të gjitha çështjet e kushtetutës.

Pranë Komisionit parlamentar ngrihet stafi teknik prej 5 vetesh, i cili do të merret me formulimin juridik të dispozitave të projektit sipas vendimeve që do të marrë Komisioni. Stafi do të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Komisionit, por nuk do të ketë të drejtë vote. Kjo bëhet për të siguruar korrektesën profesionale dhe teknikën kushtetuese, për të mënjanuar praktikën e mëparshme, kur specialistët e thirrur nga partitë politike në komision ose u politizuan ose u vunë nën presion të fuqishëm politik, dhe për pasojë u lejuan devijime pothuajse në të gjitha projektet e deritanishme.

Për të tërhequr mendimin e specializuar dhe për të zhvilluar debatin publik mendohet që të ngrihen disa grupe punë konsultative për çdo bllok problemesh kryesore të Projektkushtetutës. Monitorizuesit e këtyre grupeve do të jenë të atashuar pranë Komisionit Parlamentar. Grupet mendohet të jenë si vijon:

- a. grupi për çështjet e Parlamentit,
- b. grupi për problemet e pushtetit gjyqësor,
- c. grupi për pushtetin lokal,

- d. grupi për çështjet e administratës
- e. grupi për të drejtat e njeriut.

Me ngritjen e kësaj infrastrukture do të merret Komisioni Parlamentar.

Për ta nxjerrë procesin e hartimit të Projektkushtetutës jashtë debatit ngushtësisht politik dhe për testimin e tij para opinionit publik Komisioni Parlamentar do të ngrejë edhe një substrukturë të përkohshme që do të merret me:

- ndjekjen e debatit televiziv dhe në mediat e tjera, për të cilën parashikon të angazhojë 1-2 juristë;
- koordinimin e punës me grupet konsultative dhe agjencitë e tjera si dhe organizatat joqeveritare për realizimin e konsultave dokumentimin e opinionëve, përpilimin e raporteve për çështjet që diskutohen etj., për të cilën do të ngarkojë 2-3 juristë e sociologë.
- sondimin e opinionit publik për të përcaktuar ecurinë dhe nevojat e korrektimit eventual të procesit kushtetues, për të cilin do të angazhojë një analist sociolog.
- bashkëpunimin dhe lidhjet me shtypin për debatimin e problemeve kushtetuese, për të cilin do të ngarkohet një gazetar.

E gjithë kjo infrastrukturë e domosdoshmë për të përcjellë saktësisht dhe me efikasitet rezultatet e procesit për hartimin e Projektkushtetutës, Komisioni Parlamentar do të bashkëpunojë me ekspertë të huaj, si të institucioneve ndërkombëtare, ashtu edhe me ekspertë të vendeve të Europës dhe të SHBA, për probleme të veçanta dhe për të gjithë projektin.

Me konkretisht, konsulenca e huaj do të përfshijë kontakte aktive me organizma të njohura ndërkombëtarë sipas këtij programi:

Këshilli i Evropës (Komisioni i Venecias)
 Advocates International
 American Bar Association
 CEELI Program

Për të venë në funksionim të gjithë këtë mekanizëm që do të krijohet për organizimin dhe realizimin e procesit kushtetues është e nevojshme që puna e njerëzve që do të përfshihen të mbulohen edhe financiarisht me një fond që duhet krijuar me vendim Qeverie.

II. AFATET E PROCESIT KUSHTETUES

- | | |
|---------------------|---|
| 1-5 shtator | - Krijimi i Komisionit Parlamentar
- Krijimi i stafit teknik.
- Krijimi i grupeve konsultative. |
| 5 -10 Shtator | - Mbledhja e parë e Komisionit: Prezantimi i qendrimeve të partive (i pranishëm TV). |
| 10 Shtator-10 Tetor | - Debat televiziv, etj. , për temat e kushtetutës.
- Fushata e deputeteve me pyetsorin.
- Sondazhet në opinionet publike. |
| 10 Tetor-30 Nëntor | - Diskutime në Komision + Diskutime në grupet konsultative + përgatitja e draftit nga Stafi + Televizionimi procesit.
Çdo javë një temë, një kapitull. |
| 1-25 Dhjetor | - Oponenca e huaj për projektin. |
| 3-10 Janar | - Reflektim mbi vërejtjet e oponencës së huaj. |
| 10-31 Janar | - Depozitimi i projektit në Parlament dhe shqyrtimi i tij në grupet e komisionet parlamentare. |